



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201400155/6

Tiranë ___/___/2014

Lënda : *Rekomandim për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masës disiplinore ndaj Shefit të Komisarariatit të Policisë Shijak*

Drejtuar : **Z. Perlat ÇULLHAJ**
Drejtor i Policisë së Qarkut

Durrës

Për dijeni : **Z. Artan DIDI**
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

Tiranë

I nderuar Zoti Çullhaj,

Në institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi R.L., me banim në lagjen nr. 18, Rr. "Jeta e Re", pallati "Jashar Arza", Durrës. Ankuesi shkruan se ka gjetur një vend pune në një shoqëri që shërben si polici private. Drejtuesit e kësaj shoqërie i kanë kërkuar që të paraqiste vërtetimin e personalitetit (besueshmërisë) nga Komisarati i Policisë Shijak. Ai ka shkuar disa ditë në këtë komisarariat dhe është takuar me shefin e policisë kriminale Redjan Spaho. Redjani i ka thënë se nuk mund t'ja jepnin vërtetimin e personalitetit pasi babai i tij ka qënë i dënuar para 20 vjetësh si bashkëpunëtor në një vrasje, ndërsa për vetë atë i ka thënë se nuk kishin ndonjë problem.

Ankuesi pretendon se mosdhënia e vërtetimit të besueshmërisë nga policia e ka penguar për të filluar punë dhe sipas tij, ky qëndrim nuk është i drejtë sepse nuk ka përse të pengohet ai për një vepër që ka kryer babai i tij apo pjestarët e tjerë të familjes.

Për të zgjidhur këtë ankesë, bazuar në pikën 4, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: "*Organet dhe funksionarët publike janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij; në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për*

Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe konkretisht, në nenin 19, gërma "b" ku parashikohet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin"; si dhe në nenin 19, paragrafi i fundit, ku parashikohet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme", me shkresën tonë Nr. K2/R1-2 prot., datë 06.02.2014 i kërkuam Shefit të Komisarariat të Policisë Shijak që të verifikonte atë dhe të na dërgonte shpjegime lidhur me pretendimet e parashtruara nga ankuesi.

Ndonëse afati ligjor për kthimin e përgjigjes së shkresës tonë kaloi ai nuk na e dërgoi atë.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e rastit të ankuesit u detyruam që me shkresën Nr. K2/R1-4 prot., datë 10.03.2014 ta përsërisnim kërkesën tonë. Ndërkohë nëpërmjet kësaj shkrese i kujtuam atij se detyrimi i organeve të administratës publike për të bashkëpunuar me institucionin e Avokatit të Popullit dhe për t'i kthyer përgjigje kërkesave të tij është parashikuar në Kushtetutë dhe në ligj. Gjithashtu i bëmë të ditur se ligji nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", në nenin 22/1 të tij parashikon edhe të drejtën e Avokatit të Popullit për të kërkuar masa disiplinore ndaj punonjësve të administratës publike të cilët nuk bashkëpunojnë me të.

Megjithatë, edhe pas kërkesës së dytë ai përsëri nuk na e dërgoi përgjigjen e kërkuar nga ana jonë.

Përveç rastit të përshkruar më sipër, Shefit të Komisarariatit të Policisë Shijak, me shkresën tonë Nr. K2/M10-2 prot., datë 10.03.2014, i kemi kërkuar dërgimin brenda 10 ditëve të shpjegimeve për ankesën e bërë nga shtetasi M.V., me banim në lagjen nr.1 Sukth. Ankuesi shkruan se në datën 17.02.2014 rreth orës 18.00 ka patur një konflikt fizik me babanë e tij në banesë. Në grindje e sipër, me qëllim për t'i shpëtuar babait i cili e kishte kapur prej fyti, ai i ka kafshuar gishtin. Pas sherrit me babanë, në dhomën e tij i ka shkuar vëllai i vet dhe e ka goditur atë me thupër me gjemba.

Nga familjarët e tij është njoftuar policia, e cila ka shkuar në dhomën e tij dhe e ka arrestuar atë duke e dërguar në Komisarariat të Policisë Shijak. Ankuesi pretendon se nga punonjësit e policisë i është bërë kontrolli i banesës në kundërshtim me ligjin dhe pa patur vendim gjyqësor, dhe se gjatë kontrollit i ka humbur një unazë floriri, një vath i bashkëshortes dhe një USB. Gjithashtu ai pretendon se është goditur me grushta dhe shpulla nga shefi i krimeve në dhomën e izolimit në komisarariat.

Gjithashtu ky ankues pretendon se në datën 23. 02.2014 babai i tij po shkulte pemët që ky kishte mbjellë. Për këtë veprim të kundërligjshëm të babait ai ka telefonuar Komisarariat të Policisë Shijak, por nuk ka shkuar asnjë polic për të ndjekur problemin. Me kërkesën e policisë ai ka shkuar në komisarariat, por aty është lënë për disa orë dhe nuk i kanë marrë kallëzim. Më pas ai ka ikur në banesë dhe ka telefonuar përsëri policinë. Disa punonjës policie i kanë shkuar në banesë, e kanë marrë atë dhe futur në dhomën e izolimit si dhe nuk e kanë lejuar që të telefonojë avokatin e tij sepse i kanë hequr telefonin. Pas disa britmash dhe klithmash ai është nxjerrë nga shefi i krimeve, i cili i ka thënë që të mos i telefonojë më policisë dhe ndërkohë e ka qëlluar me shuplakë.

Ndonëse edhe për këtë rast afati ligjor i kthimit të përgjigjes kaloi, ajo nuk na u dërgua.

Moskthimi i përgjigjes së kërkuar nga Avokati i Popullit është një nga rastet tipike të mosbashkëpunimit të punonjësve të administratës publike me institucionin e Avokatit të Popullit.

Ky qëndrim i Shefit të Komisarariatit të Policisë Shijak me institucionin tonë ka sjellë pengesë në kryerjen e misionit kushtetues e ligjor të Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve dhe në kthimin në kohë të përgjigjes ankuesit. Ndërkohë ai cënon rëndë marrëdhëniet tona institucionale, si dhe imazhin e institucionit të Avokatit të Popullit në publik.

Për këto arsye, bazuar në nenin 22/1 të ligjit “Për Avokatin e Popullit” ku parashikohet se: *“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”,*

KËRKOJMË:

1. Fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masës disiplinore ndaj Shefit të Komisarariatit të Policisë Shijak.

2. Ky rast të përgjithësohet dhe t’u bëhet i njohur drejtuesve të Komisariateve të Policisë së Qarkut Durrës me qëllim që të mospërsëritet më në të ardhmen.

Për qëndrimin që do të mbani ndaj kësaj kërkesë dhe masën disiplinore që do të merrni, na vini në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT
Igli TOTOZANI

Me Urdhër dhe me Porosi
Nd/KOMISIONER

Frederik PASKALI